

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8331, DATË 21.4.1998 “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim të forcojë rregullat/procedurat për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale, të efektshmërisë në shpejtësinë e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe në kuadër të përmirësimit të procedurës së vënies në ekzekutim të vendimeve penale dhe të urdhrave të tjerë ligjorë nga organet e caktuara me ligj për zbatimin e tyre e në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me programin e qeverisë shqiptare 2017 – 2021, ku, në objektivin 3.1, “Shteti ligjor dhe drejtësia e re”, parashikohet: “Pjesë e rëndësishme e këtij procesi reformimi do të jenë edhe institucionet penitenciare, burgjet dhe paraburgimet, si dhe Shërbimi i Provës, me qëllim rritjen në mënyrë efektive të veprimtarisë së këtyre institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale. Reformim rrënjësor do të pësojë mënyra e rekrutimit të stafit policor dhe e atij civil, për të shmangur një herë e mirë emërimet politike, si dhe rritjen e profesionalizmit e të integritetit të stafit të këtij sistemi.”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji paraqitet si risi për t’iu përshtatur kërkesave të kohës, si dhe ndryshimeve ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi, si dhe garantim i veçantë i mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, garanci e drejtpërdrejtë me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Me qëllim përmirësimit të këtij ligji, si çështje kryesore në këtë projektligj janë përcaktuar çështjet, si më poshtë vijon:

1. Përgjegjësia administrative dhe/ose penale e prokurorit në rastet kur nuk ekzekuton vendimin në përputhje me përmbajtjen e tij.
2. Shtimi i detyrave të Policisë së Shtetit për ekzekutimin e dënimeve plotësuese, parashikuar në pikat 2 e 10, të Kodit Penal, konfiskimi dhe heqja e përgjegjësisë prindërore.
3. Dërgimi i vendimeve nga gjykata në formë të shkurtuar te prokurori, me qëllim procedimin për ekzekutimin e vendimit pa pritur zbardhjen e vendimit.
4. Përmirësimi i ekzekutimit të vendimit me gjysmëliri, për shkak se në ligjin për të drejtat e të dënuarve është parashikuar vendosja e tyre në institucione të hapura.
5. Shfuqizimi i kreut II, “Shërbimi i Provës”, pasi kompetencat e Shërbimit të Provës janë parashikuar në ligj të veçantë.
6. Përmirësimi i mënyrës së ekzekutimit të dënimeve për të mitur, në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
7. Përmirësimi i dispozitës për ekzekutimin e dënimit plotësues, nxjerrja jashtë territorit, dënimi me konfiskim dhe ndalimi i ushtrimit të detyrave shtetërore.
8. Shtimi i dispozitës lidhur me ekzekutimin e dënimit plotësues për “heqjen e përgjegjësisë prindërore” dhe ndalimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
9. Përmirësimi i mënyrës së ekzekutimit të masës mjekësore, duke i lënë institucionet dhe trajtimin e këtyre personave të papërgjegjshëm në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak se janë hequr nga ligji për të drejtat e të dënuarve institucionet e veçanta.
10. Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve për personat juridikë, duke përcaktuar mënyrën e ekzekutimit të të gjitha dënimeve dhe organet përgjegjëse për ekzekutimin e tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78, 81 e 83, të Kushtetutës. Pra, projektligji është në përputhje me rendin e brendshëm juridik.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 i këtij projektligji parashikon që, në rastet kur prokurori i çështjes nuk ekzekuton vendimin në përputhje me përmbajtjen e tij, mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 2 i këtij projektligji ndryshon paragrafin e parë, të nenit 10, ku, pas fjalës “prokurori”, shtohen fjalët “nga personat përgjegjës për ekzekutimin e vendimit”.

Neni 3 i këtij projektligji ndryshon nenin 11, të ligjit në fuqi, i cili riformulohet: “Gjykata. Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm, gjykata që ka dhënë vendimin, ka detyrimin të urdhërojë menjëherë, pas shpalljes së tij, ekzekutimin e vendimit penal.”.

Neni 4 i këtij projektligji riformulon nenin 16, të ligjit në fuqi, ku janë shtuar detyrat e Policisë së Shtetit, si dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me policinë gjyqësore e policinë ushtarake lidhur me kompetencat e detyrimet e tyre për ekzekutimin e vendimeve penale për personat e dënuar me burgim në gjendje të lirë, si dhe për dënimet plotësuese lidhur me nenin 30, të Kodit Penal.

Neni 5 i këtij projektligji ndryshon nenin 17, të ligjit në fuqi, ku hiqen fjalët “dënimet plotësuese të parashikuara në pikën 2, të nenit 30, të Kodit Penal”.

Neni 6 i projektligjit bën ndryshime dhe shtesa në nenin 20, për të parashikuar mënyra më të thjeshta të komunikimit me prokurorin, pra, duke e njoftuar atë drejtpërdrejt për publikimin e vendimit.

Neni 7 i këtij projektligji ndryshon paragrafin e katërt, të nenin 21, ku, fjalët “sekuestrim si masë provizore kur jepet një dënim me konfiskim” zëvendësohen me fjalët “konfiskim pasurie kur më parë është vendosur sekuestrimi”.

Neni 8 i projektligjit ndryshon nenin 22, ku, në paragrafin e parë, fjalët “menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim” zëvendësohen me fjalët “në formë të shkurtuar, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj” dhe në paragrafin e gjashtë, fjalët “në institucione të veçanta” zëvendësohen me fjalët “institucione mjekësore”. Në fund të kësaj fjalie fjalët “vepron sipas

rezultateve” zëvendësohen me fjalët “kur ka arsye në bazë të rezultateve, i paraqet kërkesë gjykatës sipas parashikimeve ligjore”.

Neni 9 i projektligjit ndryshon nenin 26, ku, në fund të paragrafit të dytë, fjalët “Për trajtimin e të dënuarve me burgim” do të zëvendësohen me fjalët “që rregullon trajtimin e të dënuarve me burgim apo të paraburgosurve”.

Neni 10 i projektligjit ndryshon paragrafin e dytë, të nenit 29, të ligjit në fuqi, i cili riformulohet: “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës, në bazë të detyrimeve nga personi i dënuar, përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri”.

Neni 11 i projektligjit ndryshon në nenin 31/4, të ligjit në fuqi, ku, në paragrafin e parë, fjalët “shkronjën “a”, të nenit 59” zëvendësohen me fjalët “nenin 59/a”, dhe në paragrafin e pestë, fjalët “zyrës përkatëse vendore” zëvendësohen me fjalët “degës territoriale”. Ndryshimet vijnë në përputhje me emërtimin e ri të degëve territoriale të zyrave të Shërbimit të Provës, në propozimin e ndryshimeve që do të sjellë projektligji i ri që është në proces shqyrtimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 12 i këtij projektligji ndryshon nenin 31/6, të ligjit në fuqi, ku bëhen ndryshimet që në paragrafin e dytë. Në fjalinë e dytë hiqen fjalët “natyra e veprës penale të kryer”, në paragrafin e tretë hiqet fjala “prejardhjen”, si dhe në paragrafin e shtatë fjalët “zyra vendore” zëvendësohen me fjalët “Dega territoriale”. Ndryshimet vijnë në përputhje me emërtimin e ri të degëve territoriale të zyrave të Shërbimit të Provës, në propozimin e ndryshimeve që do të sjellë projektligji i ri që është në proces shqyrtimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Nenet 13 e 14 të këtij projektligji shfuqizojnë nenet 31/7 e 31/8, të ligjit në fuqi, dispozita lidhur me kompetencat e Shërbimit të Provës, për shkak se këto ndryshime vijnë në përputhje me emërtimin e ri të degëve territoriale të zyrave të Shërbimit të Provës, në propozimin e ndryshimeve që do të sjellë projektligji i ri që është në proces shqyrtimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 15 i projektligjit ndryshon nenin 31/9, ku, në paragrafin e dytë, pas fjalës “i burgosur” shtohen fjalët “apo i paraburgosur” dhe pas fjalës i “dënuari” shtohen fjalët “apo i paraburgosuri”, si dhe në fund të fjalisë së paragrafit të gjashtë shtohen fjalët “për një vepër tjetër penale”.

Neni 16 i këtij projektligji ndryshon nenin 31/10, ku bëhen ndryshimet që në paragrafin e parë: fjalët “e pjesshëm a të plotë të dënimit alternativ” zëvendësohen me fjalët “e dënimit alternativ me një dënim alternativ tjetër ose me burgim” dhe, në paragrafin e tretë, fjalët “ndryshimin ose revokimin”

zëvendësohen me fjalët “revokimin dhe ndryshimin” dhe fjala “alternative” ndryshohet me fjalën “të mëparshëm”.

Nenet 17 e 18, të projektligjit shfuqizojnë përkatësisht nenet 31/12 dhe paragrafin e tretë, të nenit 32, të ligjit në fuqi, dispozita në lidhje me kompetencat e Shërbimit të Provës, për shkak se këto ndryshime vijnë në përputhje me emërtimin e ri të degëve territoriale të zyrave të Shërbimit të Provës, në propozimin e ndryshimeve që do të sjellë projektligji i ri që është në proces shqyrtimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 21, i projektligjit, ndryshon paragrafin e dytë, të nenit 39, duke parashikuar në këtë mënyrë që, kur i dënuari është shtetas i huaj ose person pa shtetësi, si dhe ka pasur dënim kryesor burgimin, Policia e Burgjeve ia dorëzon Policisë së Shtetit, e cila kryen procedurat për nxjerrjen jashtë territorit.

Neni 22 i projektligjit ndryshon nenin 40, të ligjit në fuqi, ku, në paragrafin e parë, fjalët “nga organi përmbartimor kompetent, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm” zëvendësohen me fjalët “drejtpërdrejt nga organi i prokurorisë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit”, dhe paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 23 i projektligjit ndryshon nenin 41, të ligjit në fuqi, ku, në fund të paragrafit të parë, fjalët “që e ka emëruar ose që ka lidhur marrëdhëniet e punës i dënuari, me largimin nga detyra përkatëse, duke respektuar rregullat ligjore përkatëse” zëvendësohen me fjalët “që merr kërkesën për punësim ose organit që ka tagër ta emërojë, brenda afatit ndalues të dënimit plotësues të dhënë nga gjykata” dhe paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 24 i projektligjit ndryshon nenin 42, të ligjit në fuqi, ku fjalët “dokumentin për kohën e caktuar në vendimin e gjykatës” zëvendësohen me fjalët “të drejtën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo mjeshtërisë së caktuar”.

Neni 25 i projektligjit shton një dispozitë të re “Neni 44/1”, me përmbajtje: Heqja e së drejtës prindërore. Në ekzekutimin e këtij vendimi prokurori i vë në dispozicion urdhrin e ekzekutimit organeve të Policisë së Shtetit të vendbanimit ose vendqëndrimit të fëmijës, me qëllim mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit sipas vendimit të gjykatës.”.

Gjithashtu, nëpërmjet nenit 25, të projektligjit, shtohet neni 44/2, duke reflektuar në këtë mënyrë ndryshimet që janë iniciuar në Kodin Penal, konkretisht “Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 26 i projektligjit ndryshon nenin 45, të ligjit në fuqi, ku, në fund të paragrafit të parë, fjalët “sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit.” zëvendësohen me fjalët “për subjekte që nuk mbajnë përgjegjësi penale për veprën e kryer.”.

Paragrafi i dytë riformulohet duke përmirësuar mënyrën e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit të prokurorit, duke përcaktuar rast pas rasti autoritetet përgjegjëse për ekzekutimin e këtij urdhri.

Neni 27, me ndryshimet që sjell në nenin 46, të ligjit në fuqi, saktëson emërtimin e institucioneve në përputhje me Kodin Penal për të Miturit, konkretisht, “institucionet e posaçme të edukimit të të miturve.” zëvendësohen me “qendra/institucione publike ose private, të cilat janë të pajisura me infrastrukturën dhe personelin e duhur, për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.”.

Neni 28 i projektligjit bën shtesa dhe ndryshime në të cilën në titullin e dispozitës zëvendësohen fjalët “masat penale” me fjalët “Dënimet kryesore”. Në paragrafin e parë fjalët “masë penale” zëvendësohen me fjalët “dënim me gjobë”.

Njëkohësisht mbas paragrafit të parë shtohet një paragraf për të përmirësuar ekzekutimin e vendimeve për personat juridikë, duke përcaktuar mënyrën e ekzekutimit të të gjitha dënimeve dhe organet përgjegjëse për ekzekutimin e tyre.

Si një risi, në nenin 29, të projektligjit, parashikohet shtimi i disa dispozitave pas nenit 47, të ligjit në fuqi, dhe, konkretisht, nenet 47/1, 47/2, 47/3 dhe 47/4, për mënyrën e procedimit të ekzekutimit të vendimeve të dënimeve jo me burgim për të miturit, të dënimit me burgim, si dhe të dënimeve me gjobë, si një garanci që buron nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 30, i projektligjit, sjell ndryshime në nenin 48, ku pika 1, e këtij neni riformulohet, me këtë përmbajtje:

“1. Për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe që nuk janë ankuar ose nuk është ushtruar rekurs, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit të shkurtuar brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë”.

Ndërsa pika 2 shfuqizohet.

Në pikën 3, pas fjalës “vendimet” shtohet fjala “e shkurtuara”, si dhe pas fjalës “dënime” shtohet fjala “të tjera”.

Pas pikës 4 shtohet paragrafi me përmbajtje: “Për vendimet ndaj personave juridikë, gjykata i dërgon prokurorit, brenda 5 ditëve, vendimin e shkurtuar”.

Neni 31, i projektligjit, sjell ndryshime dhe shtesa në nenin 49, të ligjit në fuqi, ku, në fjalinë e parë, fjalët “dhe lëshon” zëvendësohen me fjalët “për të cilën lëshon dhe dërgon”.

Pas pikës 5 do të shtohet pika 6, me përmbajtje: “Për dënimet ndaj personave juridikë urdhri i ekzekutimit nxirret brenda 5 ditëve nga marrja e shkurtimit të vendimit.”.

Neni 32, i projektligjit, shton një paragraf pas paragrafit të dytë, të nenit 50, të ligjit në fuqi, me përmbajtje: “Urdhri i ekzekutimit për vendimet penale ndaj personave juridikë ekzekutohet brenda 5 ditëve nga marrja e tij.”.

Neni 33, i projektligjit, nëpërmjet ndryshimit të fjalisë së dytë, të paragrafit të parë, të nenit 52, qartëson se kush është prokurori kompetent në rastet kur ekzekutimi i vendimit bëhet në një vend të ndryshëm nga ai i gjykatës që e ka dhënë atë vendim.

Neni 34, i projektligjit, ndryshon pikën 2, të nenit 53, të tij, ku fjalët “mbrojtësit të tij” zëvendësohen me fjalët “mbrojtësve të tyre”.

Neni 35, i projektligjit, ndryshon nenin 54, ku, në paragrafin e parë, fjalët “nga personi zyrtar i pranishëm, i cili ka të drejtë të pasqyrojë pretendimet e tij” zëvendësohen me fjalët “... prej tij. Personi zyrtar i pranishëm ka të drejtë të pasqyrojë pretendimet e tij.”.

Neni 36, i projektligjit, ndryshon nenin 56, të ligjit në fuqi, ku, pas fjalës “prokurori”, shtohen fjalët “fillon ndjekje penale, ose ...”.

Neni 37, i projektligjit, ndryshon nenin 65, të ligjit në fuqi, ku, në paragrafin e parë, pas fjalëve “Prokurori i Përgjithshëm ...” shtohen fjalët “... , drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ministri i ...”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Drejtësisë, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria e Përgjithshme dhe ministri përgjegjës për rendin publik.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit me kontributin e ekspertëve të Ambasadës Britanike në Tiranë.

Projektligji, në zbatim të ligjit nr.146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit në portalin e “Regjistrimit elektronik për njoftime dhe konsultime publike”, për të cilin, mbas kalimit të afatit ligjor të publikimit, nuk ka pasur komente për përmbajtjen e projektligjit.

Në datat 15 – 16 prill 2019, projektligji është diskutuar në tryeza të organizuara pranë Ministrisë së Drejtësisë, për konsultimin e projektligjeve të sistemit penitenciar.

Në kuadër të tryezës së konsultimit, komentet e përcjella nga institucionet e interesuara, si dhe nga organizatat jofitimprurëse, janë vlerësuar nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë e janë reflektuar në përmbajtje të projektligjit dhe të relacionit shoqërues.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk ka efekte shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE